

**SIGKOS SH.A.**

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare për vitin që ka  
përfunduar më 31 dhjetor 2018**

<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>FAQE</b>
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1-3
PASQYRA E FITIMIT APO HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	6
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	7
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE	8 - 48
ANEKS A - OPINIONI I AKTUARIT	

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për menaxhmentin dhe aksionarët e SIGKOS Sh.a

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të SIGKOS Sh.a ("Kompania"), që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar në këtë datë, dhe shënimet për pasqyrat financiare duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas mendimit tonë përveç efekteve të mundshme të çështjes së diskutuar në paragrafin e seksionit të raportit tonë mbi Bazat për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të kompanisë më 31 dhjetor 2018, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinion të Kualifikuar

- i. Siç është shpalosur në shënimin 19 të pasqyrave financiare shoqëruese, më 31 dhjetor 2018 dhe 2017, bilanci i aseteve të tjera afatshkurtëra, përfshin llogaritë e arkëtueshme nga Byroja e Sigurimeve të Kosovës (BKS) në vlerë prej 1,058,808. Kompania nuk ka bërë vlerësimin për provizionimin e të arkëtueshmeve pavarësisht egzistencës së provave objektive për zhvlerësim, siç është vonesa e pagesës nga BKS për më shumë se dy vjet. Përveç kësaj, BKS nuk i konfirmoi këto të arkëtueshme në letrën e konfirmimit të dërguar tek ne si pjesë e procedurave tona të auditimit. Për këtë bilanc kompania ka ngritur një padi gjyqësore kundër BKS-së, e cila është ende në procedurë që nga data e miratimit të këtyre pasqyrave financiare. Gjatë vitit 2017, gjykata e shkallës së parë në Gjykatën Themelore ka vendosur në favor të Kompanisë. Rrjedhimisht, ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim i kësaj të arkëtueshmeve ishte i nevojshëm, sipas mendimit tonë këto rregullime mund të jenë të rëndësishme. Përveç kësaj, rregullimi i mundshëm i të arkëtueshmeve nga BKS do të ndikonte në llogaritjen e adekuatshmërisë së kapitalit dhe fondit të garancisë më 31 dhjetor 2018.

Theksimi i çështjeve

Ne tërheqim vëmendjen për çështjet e mëposhtme:

- ii. Siç është shpalosur në Shënimin 5 të pasqyrave financiare shoqëruese, në bazë të Rregullores për investimin e aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike si dhe investimet e kapitalit themeltar për siguruesit të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"), të gjitha kompanitë e sigurimit janë të detyruar të mbajnë asete në mbulim të provizioneve teknike prej 85% në 31 dhjetor 2018 (70% në 31 dhjetor 2017). Më 31 dhjetor 2018, asetet për mbulimin e provizioneve teknike rezultojnë në 2,277,963 euro, që përfaqëson 65% të provizioneve teknike (31 dhjetor 2017 2,280,802 euro, që përfaqëson 65% të provizioneve teknike).



- iii. Siç është shpalosur më tej në Shënimin 4 të pasqyrave financiare shoqëruese, në pajtim me Rregulloren për llogaritjen e kufirit minimal të aftësisë paguese, adekuatshmërisë së kapitalit dhe fondit garantues për siguruesit jo-jetës të lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"), kapitali i siguruesve që ushtrojnë veprimtari me klasat e sigurimeve të jo-jetës dhe kapitali i siguruesve që ushtrojnë veprimtari në fushën e risigurimeve nuk duhet të jetë më i ulët se niveli i kërkuar i aftësisë paguese të siguruesve. Më 31 dhjetor 2018, Kompania ka deficit në fondin e garancisë në vlerë prej 1,260,568 euro (më 31 dhjetor 2017 ka deficit 1,273,613).

Përveç kësaj, nëse do të ishte njohur ndonjë rregullim si rezultat i kufizimeve të fushëveprimit tonë të përcaktuar në paragrafët e Bazës për Opinione të Kualifikuara, deficitin në fondin e garancisë mund të kishte qenë më i lartë.

#### **Çështje të tjera**

Pasqyrat financiare të Kompanisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 janë audituar nga një auditor tjetër i cili shprehu një opinion të kualifikuar me theksim të çështjes për këto pasqyra.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinionin tonë të kualifikuar.

#### **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personat të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së kompanisë për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likujdijë Kompaninë apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Personat të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesin e raportimit financiar të Kompanisë.



## Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë edhe informacione të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksione dhe ngjarje në mënyrë të drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.




**Raportet tjera për kërkesat e autoritetit mbikëqyrës, Bankës Qendrore të Kosovës, për Investimet në Rezervat Teknike .**

Në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK"), neve kemi lexuar Pasqyrat Plotësuese të bashkangjitura për Investimet në Rezervat Teknike ("Pasqyrat Plotësuese"). Këto Pasqyrat Plotësuese të përgatitura nga ana e Menaxhmentit nuk janë pjesë e pasqyrave financiare shoqëruese. Informacione historike financiare të paraqitura në tabelat shtese përgatitur nga menaxhmenti, janë në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me informacionin vjetor financiar shpalosura në pasqyrat financiare shoqëruese të Kompanisë më 31 dhjetor 2018, të përgatitura në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të aplikueshme për kompanitë e sigurimeve në Kosovë.

Menaxhmenti është përgjegjës për të përgatitur Pasqyrat Shtesë në pajtim me Rregulloren e BQK-së , për investimin e aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike si dhe investimin e kapitalit themeltar të siguruesve.

Prishtinë, 24 prill 2019

BDO Kosova L.L.C.  
Rr. Perandori Justinian, Nr. 120  
10 000 Prishtinë, Kosovë

  
Samir Tahiraga  
Partner i angazhimit

  
BDO Kosova L.L.C.  
audit, accounting and financial advisory  
Prishtina, Kosova

KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGKOS SH.A.

Pasqyra e fitimit apo humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse

Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2018

		Për fund vitin 31 dhjetor 2018 (në EUR)	Për fund vitin 31 dhjetor 2017 (në EUR)
	Shënime		
Primet bruto të shkruara	7	1,750,029	1,907,150
Tatimi në prim 5%		(95,627)	(107,008)
Primet e lëshuara ri-siguruesve		<u>(92,119)</u>	<u>(147,744)</u>
<b>Neto primet e shkruara</b>		<u><b>1,562,283</b></u>	<u><b>1,652,398</b></u>
Neto ndryshimi i rezervave për primet e pa fituara		<u>43,470</u>	<u>191,356</u>
<b>Primi i fituar neto nga taksa mbi primin</b>		<u><b>1,605,753</b></u>	<u><b>1,843,754</b></u>
Të ardhura nga Byroja e Sigurimit të Kosovës (BKS)	8	162,518	233,002
Të hyrat nga interesi	9	89,013	85,661
Të hyrat tjera	10	<u>144,203</u>	<u>158,852</u>
<b>Total të hyrat</b>		<u><b>2,001,487</b></u>	<u><b>2,321,269</b></u>
Humbjet dhe shpenzimet e dëmeve pezull	21	(641,119)	(758,584)
Shpenzime për Byronë e Sigurimit të Kosovës (BKS)	8	(157,406)	(176,406)
Kontribute për Byronë e Sigurimit të Kosovës - Fondi i kompensimit	11	(79,020)	(114,258)
Shpenzimet administrative dhe të marketingut	12	<u>(1,119,545)</u>	<u>(1,603,526)</u>
<b>Total shpenzimet</b>		<u><b>(1,997,090)</b></u>	<u><b>(2,652,774)</b></u>
<b>Fitimi/(Humbja) Neto</b>		<u><b>4,397</b></u>	<u><b>(331,505)</b></u>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Rivlerësimi i objekteve		-	198,301
<b>Total të ardhurat (humbjet) gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<u><b>4,397</b></u>	<u><b>(133,204)</b></u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiar

KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGKOS SH.A.  
Pasqyra e pozicionit financiar  
Më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Me 31 dhjetor 2018 (në EUR)	Me 31 dhjetor 2017 (në EUR)
<b>PASURITË/ASETET</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	13	340,171	689,002
Depozitat	14	4,045,183	3,745,183
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi	15	143,052	107,846
Kosto e shtyrë e marrjes në sigurim	16	183,250	168,708
Asetet e risigurimit	21	108,611	108,611
Toka dhe paisjet	17	775,109	782,237
Asetet e paprekshme	18	48,014	55,000
Asetet të tjera afatshkurtra	19	1,194,254	1,158,531
<b>TOTAL PASURITE/ASETET</b>		<b>6,837,644</b>	<b>6,815,118</b>
<b>EKUITETI I AKSIONARËVE DHE DETYRIMET</b>			
<b>KAPITALI</b>			
	20		
Kapitali aksionar		3,406,850	3,406,850
Rivlerësimi i rezervës		221,398	221,398
Humbje të akumuluar		(417,388)	(421,785)
<b>TOTAL EKUITETI I AKSIONARËVE</b>		<b>3,210,860</b>	<b>3,206,463</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Rezerva e dëmeve pezull	21	2,277,963	2,280,802
Rezerva e primit të pafiturar	22	1,028,839	1,072,310
Hua afatshkurtër/afatgjata	23	25,069	25,051
Detyrime të tjera	24	294,913	230,492
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>3,626,784</b>	<b>3,608,655</b>
<b>TOTAL OBLIGIMET/DETYRIMET DHE EKUITETI I AKSIONARËVE</b>		<b>6,837,644</b>	<b>6,815,118</b>

Autorizuar nga menaxhmenti për botim dhe nënshkruar më 7 mars 2019.

Zt. Ibrahim Kastrati  
Drejtor i Përgjithshëm

Znj. Doruntina Shatri Mahmuti  
Drejtoreshë Financiare

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave  
financiare



KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGKOS SH.A.

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2018

	Kapitali Aksionar (në EUR)	Rezervat e rivlerësuara	Fitimi / Humbja e akumuluar (në EUR)	TOTAL (në EUR)
Me 1 janar 2017	3,406,850	23,097	(90,280)	3,339,667
Transaksione me aksionarët	-	-	-	-
Humbja e vitit	-	-	(331,505)	(331,505)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Rivlerësimi i objekteve (Shënimi 17)	-	198,301	-	198,301
Totali i të ardhurave (humbja) gjithëpërfshirëse	-	198,301	(331,505)	(133,204)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2017</b>	<b>3,406,850</b>	<b>221,398</b>	<b>(421,785)</b>	<b>3,206,463</b>
Me 1 janar 2018	3,406,850	221,398	(421,785)	3,206,463
Transaksione me aksionarët	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	4,397	4,397
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i të ardhurave (humbja) gjithëpërfshirëse	-	-	4,397	4,397
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>3,406,850</b>	<b>221,398</b>	<b>(417,388)</b>	<b>3,210,860</b>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave  
financiare

KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGKOS SH.A.

Pasqyra e të rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2018

	Shënim	Për fund vitin 31 dhjetor 2018 (në Euro)	Për fund vitin 31 dhjetor 2017 (në Euro)
<b>Aktivitetet operative</b>			
Fitimi/(Humbja) neto për vitin		4,397	(331,505)
<i>Korrigjime për zërat jo monetare:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	17,18	52,920	31,719
Ndryshimet nga balanca e llogarive të arkëtueshme		106,586	386,437
Lirimi nga zhvlerësimi i provizionit për të arkëtueshmet e shlyera më parë		(90,176)	(118,681)
Të hyrat nga shitja e veturave		(24,486)	(6,375)
Të ardhurat nga interesi		(89,013)	(95,179)
		(39,772)	(133,584)
<i>Ndryshime në asetet operative</i>			
Të arkëtueshmet nga sigurimi		(5,140)	68,945
Kostot e shtyra të marrjes në sigurim		(14,542)	65,687
Asetet tjera afatshkurtëra		(20,368)	133,925
		(79,822)	134,973
<i>Ndryshimet në detyrimet operative</i>			
Humbja në provizionimet e dëmeve pezull		(2,839)	14,216
Provizionimi për primet e pafituara	22	(43,471)	(191,355)
Të pagueshmet tjera dhe tregtare		64,439	(5,876)
<b>Neto paraja (e përdorur) / gjeneruar nga aktivitetet operative</b>		<b>(61,693)</b>	<b>(48,042)</b>
<b>Aktivitetet investive</b>			
Blerja e pronës dhe paisjeve	17	(34,531)	(1,534)
Blerja e aseteve të paprekshme	18	(4,272)	(13,810)
Rritja e depozitave		-	(2,293,736)
Zvoglimi i depozitave	14	(300,000)	2,543,736
Interesi i arkëtuar		51,665	134,773
<b>Neto paraja (e përdorur) në aktivitetet investive</b>		<b>(287,138)</b>	<b>(369,429)</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>			
Dividenda e paguar		-	-
<b>Neto paraja (e përdorur) në aktivitetet financuese</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Neto ndryshimet në para dhe në ekuivalentët e parasë</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		(348,831)	321,387
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	13	369,002	47,615
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>		<b>20,171</b>	<b>369,002</b>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare